



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

Nr \_\_\_\_ Prot.,

Data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PËR OBJEKTI I PROKURIMIT: “Asfaltimi i rruges nga aksi Gramsh-Elbasan deri në rrugët e brendshme të fshatit Qerret, NJ.A.Pishaj Bashkia Gramsh”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT:** Punime rrugore 45233140-2

**FONDI LIMIT:** me fond limit 19,532,116 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 23,438,539 (njëzet e tre milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekë me TVSH. Konkretisht për vitin 2026 do të financohet vlera 4 688 000 (katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tete mije) lek me tvsh, në vitin 2027 vlera 9 700 000 (nëntë milion e shtatëqind mijë) lekë me tvsh dhe për vitin 2028 vlera 9 050 539 (nëntë milion e pesëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **bashkia Gramsh**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

2.1.1 Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontrates që do të prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

**Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998** “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5** datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar pika 3.12 e tij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018** ”Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 i tij ku parashikohet: ”Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet

*për veprimtarinë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministripërgjegjës për financat”.*

**Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009** “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjukojme që të kërkojme xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022, 2023, 2024) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”*

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2026**, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

**Argumentimi:** Njësia e prokurimit kërkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (të ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

a) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- f. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9

*Shenim: Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

**Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1 A Punime germimi ne toke**
- **NP-4 A Rruge, Autostrada, ura mbikalime**
- **NS-18 A Punime topogjeodezike**

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja përkriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

### **NP-1 A Punime gjërmimi në tokë**

Sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjërmimi në tokë konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore ose zhavorrishte.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjërmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i ndërtimit të ri të konceptuar në disa godina ku në katin përdhe janë të bashkuara disa prej tyre në bazë të funksioneve ndëlidhëse. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjërmimit dhe sistemimit, kapitulli punimet ndërtimore dhe kapitulli punime hidraulike në preventivin e punimeve dhe në paragrafët

përkatës, punime dhe dhe germimi në specifikimet teknike të punimeve strukturore. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### Argumentimi teknik

Kjo licemce justifikohet drejtperdrejt nga zerat :

- Germim dheu me eskavator;
- Transport materiali;
- Germime ne kuneta;
- Germime per tubacione HDPE SN8;
- Germime per pusetat;
- Formimi i trupit te rruges.

Preventivi permban mbi 500 m<sup>3</sup> germime dhe mbi 700 m<sup>3</sup> mbushje e sistemime, te cilat perbejne fazen baze te realizimit te objektit. Pa kete kategori nuk mund te realizohen shtresat ruogore, kullimi apo ndricimi.

#### ➤ NP-4 A Rruge, Autostrada, ura mbikalime

Sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaj, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

#### Argumentim Teknik

Kjo eshte licenca kryesore e objektit ku argumentohet nga zerat:

- Shtrese cakelli;
- Shtrese stabilizanti;
- Mbushje me cakell;
- Emulsion bituminoz;
- Binder;
- Tapet asfaltik;
- Bankina;
- Trotuare;

- Bordure;
- Sinjalistike horizontale;
- Guardrail.

Mbi 2560 m<sup>2</sup> binder dhe 2560 m<sup>2</sup> tapet asfaltik perbejne aktivitetin kryesor te kantierit dhe kerkojne drejtim Teknik te specializuar rrugor.

## **NS-18 A Punime topogjeodezike**

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008, të ndryshuar, kategoria NS-18 B “Punime topogjeodezike.” Kjo pikë licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj. Gjithashtu është vendosur në përputhje me punimet që do të realizohen bazuar në projektin e zbatimit dhe në preventivin e punimeve. Konkretisht kjo kategori licence është e domosdoshme për piketimin e kanalit që do të gërmohet që të jete sipas kuotave dhe distancave të projektit. Është kërkuar sipas parashikimeve në relacionin teknik topografik dhe specifikimet teknike, ku kërkohet që kontraktori të marrë përsipër zbatimin e projektit inxhinierik, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

### Argumentim Teknik

Edhe kjo licence është plotësisht e justifikuar sepse objekti përfshin :

- Puketim aksi rrugor;
- Kuotim të gërmimeve;
- Kutim të shtresave;
- Kuotim të trotuareve;
- Vendosje të pusëve;
- Vendosje të shtyllave të ndricimit;
- Kontroll të profileve gjatësore dhe tërthore

Gjithashtu duhet theksuar se janë parashikuar edhe pajisjet GPS dhe Total Station, të cilat lidhen drejtpërdrejt me këtë licence.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

Inxhinier Ndërtimi

1 (një)

Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
Inxhinier Elektrik	1 (një)
Inxhinier Gjeodet	1 (një)
Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për Inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i Inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

## ➤ ARGUMENTIM MBI STAFIN TEKNIK INXHINIERIK

### 1. Inxhinier Ndertimi – 1 person

Argumentim Teknik

Prania e 1 ( nje) inxhinieri ndertimi eshte e domosdoshme, pasi ai do te kryeje drejtimin Teknik te punimeve dhe koordinimin e te gjitha proceseve ndertimore te objektit ne kantier.

Objekti perfshin punime te ndryshme infrastrukturore si germime dheu, shtresa rrugore, asfaltime, ndertim kunetash e bankinash, mure pritesa betoni, trotuare, bordure, sinjalistike dhe punime ndricimi. Keto procese kerkojne kontroll te vazhdueshem Teknik per garantimin e cilesise dhe respektimin e projektit.

Inxhinieri i ndertimit do te drejtoje dhe kontrolloje realizimin e zerave kryesore te preventivit, konkretisht :

- Germimet dhe sistemimet e trupit te rruges;
- Shtresen e cakullit me trashesi 20 cm;
- Shtresen stabilizuese 15 cm ;
- Mbushjet me cakell dhe ngjeshjen sipas kerkesave teknike;
- Shtrimin e binderit dhe tapetit asfaltik;
- Ndertimin e murit prites prej betoni;
- Punimet e trotuareve dhe bordurave;
- Punimet e bankinave;
- Koordinimin e punimeve te sinjalistikes dhe ndricimit.

Gjithashtu ai do te organizoje grupet e punes, makinerite dhe furnizimin me materiale, duke siguruar realizimin e objektit brenda afatit kontraktor prej 90 ditesh kalendarike.

Per shkak te natyres se punimeve dhe volumit te preventivit, 1 (nje) inxhinier ndertimi eshte i domosdoshem dhe plotesisht i justifikuar dhe argumentuar.

## **2. Inxhinier Hidroteknik – 1 person**

Argumentim Teknik

Objekti permban nje numer te konsiderueshem punimesh qe lidhen me sistemimin dhe largimin e ujrave siperfaqesor, te cilat ndikojne drejtperdrejt ne jetegjatesine e rruges.

Prania e inxhinierit hidroteknik justikohet nga keto zera te preventivit :

- Ndertimi i kunetave kulluese;
- Vendosja e tubave HDPE SN8  $\Phi$  315;
- Ndertimi i pusetave prej betoni;

## **3. Inxhinieri Gjeodet – 1 Person**

Argumentim teknik

Objekti perfshin ndertimin e një rruge me gjatësi 850 m, realizimin e kunetave anësore, vendosjen e tubacioneve të drenazhimit, ndertimin e mureve pritëse, trotuareve, dhe elementëve

të sinjalistikës rrugore. Të gjitha këto punime kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të pozicionimit dhe kuotave sipas projektit.

Inxhinieri gjeodet është përgjegjës për:

- pikëtimin e aksit të rrugës;
- përcaktimin e kuotave të gërmimit dhe mbushjes;
- kontrollin e shtresave rrugore gjatë ndërtimit;
- pikëtimin e kunetave dhe tubave të drenazhimit;
- verifikimin e pozicionit të mureve prites;
- pikëtimin e trotuareve, bordurave ;
- kontrollin perfundimtar të dimensioneve dhe kuotave të vepres.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të punimeve tokësore, shtresave rrugore dhe elementëve të infrastrukturës lineare, prania e Inxhinierit Gjeodet është e domosdoshme për të garantuar realizimin e punimeve sipas projektit dhe shmangien e devijimeve gjeometrike që mund të ndikojnë në funksionalitetin dhe jetëgjatësinë e rrugës.

#### **4. Inxhinieri Elektrik – 1 Person**

Argumentimi Teknik

Preventivi parashikon një seksion të veçantë "Punime Ndriçimi", ku përfshihen:

- 13 puseta elektrike kontrolli;
- 13 elektroda tokezimi;
- 13 shtylla metalike ndriçimi H=7 m;
- 13 krahe shtyllash;
- 1000 ml tub HDPE;
- 1 kuader komandimi;
- 1000 ml kablllo XLPE Al 4x16 mm<sup>2</sup>

Këto volume përbëjnë një sistem të plotë të ndriçimit rrugor dhe kërkojnë drejtim teknik të specializuar.

Inxhinieri elektrik është përgjegjës për:

- Organizimin dhe mbikqyrjen e punimeve të ndriçimit;
- Kontrollin për vendosjen e tubacioneve dhe kablllove;
- Kontrollin për sistemimin e tokezimit;
- Montimin dhe verifikimin e shtyllave të ndriçimit;
- Kontrollin e kuadrit komandues;
- Testimin dhe venien në funksion të rrjetit të objektit;
- Garantimin e sigurisë elektrike gjatë zbatimit.

Duke qenë se rrjeti i ndriçimit përbën një sistem teknik të veçantë brenda projektit, prania e Inxhinierit Elektrik është e nevojshme për garantimin e cilësisë së instalimeve, sigurisë së përdoruesve dhe funksionimit korrekt të sistemit të ndriçimit.

## 5. Inxhinieri i Mjedisit – 1 Person

### Argumentimi Teknik

Punimet e parashikuara përfshijnë:

- 512 m<sup>3</sup> germime;
- 768 m<sup>3</sup> mbushje me cakell;
- 384 m<sup>3</sup> shtrese stabilizanti;
- Transport materialesh;
- Asfaltim te siperfaqeve rrugore;
- Ndertim kunetash dhe drenazhimesh;
- Ndertim muresh pritesë;
- Punime trotuari ;
- Punime ndricimi.

Këto punime apo zera ndertimore gjenerojnë pluhur, zhurmë, materiale të tepërta gjermimi, mbetje ndërtimore dhe ndikime të përkohshme në mjedisin përreth.

Inxhinieri i Mjedisit është përgjegjës për:

- Monitorimin e ndikimeve mjedisore gjatë punimeve;
- Kontrollin e masave për reduktimin e pluhurit;
- Kontrollin e zhurmave nga makineritë;
- Menaxhimin e materialeve të tepërta dhe mbetjeve;
- Mbrojtjen e kunetave dhe rrjedhjeve natyrore të ujërave;
- Monitorimin e ndotjeve të mundshme nga karburantet dhe vajrat;
- Zbatimin e masave të parashikuara në dokumentacionin mjedisor.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të gjermimeve, transportit të materialeve, asfaltimit dhe ndërhyrjeve në infrastrukturën ekzistuese të fshatit, prania e Inxhinierit të Mjedisit është e domosdoshme për garantimin e zhvillimit të punimeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a. (Një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumine daten e hapjes se tenderit.

Ose kontratë shërbimi me subjekte private të licensuara për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

**Argumentimi:** Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" ku citohet..... "Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion".

Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë harton planin e sigurisë dhe të koordinimit në kantiere, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, hartojnë planin operativ të sigurisë, kryejnë mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

Në rregulloren për sigurinë në kantiere miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantiere e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantiere e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- Betonues	2 (dy)
- Murator	2 (dy)
- Hekurthyes	2 (dy)
- Elektracistë	2 (dy)
- Hidraulik	2 (dy)
- Karpentier	2 (dy)
- Asfaltoshtrues	2 (dy)
- Automakinist	1 (një)
- Eskavatorist	1 (një)
- Shofer	2 (dy)
- Buldozerist	1 (një)

**Teknik me shkolle te mesme**

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Teknik Topograf/Gjeodet/Gjeometër 1 ((një)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr Amzes
1					
2					
etj					

Për keta punonjes, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (Diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- Përpunonjësit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:
  - Kontratë nindivduale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shoferejanëtëkontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin

*dhe formimin profesional në R.Sh.* ”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional.

### **1. Teknik Ndërtimi – 1 person**

Prania e një Tekniku Ndërtimi është e nevojshme për ndjekjen e përditshme të punimeve në kantier dhe për zbatimin praktik të udhëzimeve të Inxhinierit të Ndërtimit.

Tekniku do të kontrollojë:

- Organizimin e fronteve të punës;
- Shpërndarjen e punëtorëve;
- Matjet ditore të volumeve të realizuara;
- Kontrollin e materialeve që hyjnë në objekt;
- Evidentimin e punimeve sipas grafikut.

Duke qenë se punimet shtrihen në disa kategori (rrugë, kullim, trotuare, ndriçim), një teknik është i mjaftueshëm dhe i justifikuar.

### **2. Teknik Topograf – 1 person**

Tekniku topograf asiston Inxhinierin Gjeodet në punimet e matjeve dhe piketimit.

Ai do të angazhohet në:

- Vendosjen e piketave;
- Kontrollin e profileve;
- Matjen e volumeve të gërmimeve;
- Verifikimin e kuotave të shtresave rrugore;
- Kontrollin e pozicionimit të pusëve dhe shtyllave.

Për shkak të matjeve të vazhdueshme gjatë gjithë objektit, një teknik topograf është plotësisht i justifikuar.

### **3. Punonjës Karpentier – 2 persona**

Dy karpentierë justifikohen nga punimet e betonit të parashikuara në preventiv.

Ata do të realizojnë:

- Kallëpet e murit pritës prej betoni;
- Kallëpet e pusëve;
- Kallëpet e trotuareve;
- Kallëpet e bordurave;

- Elementët ndihmës të betonimeve.

Volumi i betonit nuk është shumë i madh, por punimet janë të shpërndara në disa zëra të ndryshëm.

Për këtë arsye 2 karpentierë janë numër optimal dhe i justifikuar.

#### **4. Punonjës Betonues – 2 persona**

Punimet me beton përfshijnë:

- Murin pritës;
- Pusetat;
- Trotuaret;
- Bordurat;
- Elementët ndihmës të kullimit.

Dy betonues janë të nevojshëm për:

- Hedhjen e betonit;
- Vibrimin;
- Nivelimin;
- Përfundimin e sipërfaqeve.

Volumet nuk kërkojnë ekip të madh betonimi, por kërkojnë vazhdimësi pune sipas grafikut.

Prandaj 2 betonues janë të justifikuar.

#### **5. Punonjës Murator – 2 persona**

Punimet e muraturës lidhen kryesisht me:

- Ndërtimin e pusetave;
- Rakordimet e elementëve të kullimit;
- Punime ndihmëse në trotuare;
- Sistemime të ndryshme civile.

Duke qenë se këto punime nuk zhvillohen njëkohësisht në disa fronte të mëdha, 2 muratorë konsiderohen të mjaftueshëm.

#### **6. Punonjës Hekurkthyes – 2 persona**

Pas analizimit të preventivit, rezulton se:

- Muri betonarme ka volum të kufizuar;
- Trotuaret kanë armaturë të lehtë;
- Bordurat kanë armaturë minimale.

Volumi i përgjithshëm i armaturës nuk justifikon praninë e përhershme të 3 hekurkthyesve.

Dy hekurkthyes mund të kryejnë:

- Prerjen e armaturës;
- Përkuljen;
- Montimin;
- Vendosi në kallëpe.

Grafiku i punimeve nuk paraqet situatë ku nevojiten njëkohësisht tre fronte armimi.

## **7. Punonjës Elektracist – 2 persona**

Dy elektracistë justifikohen si rezultat i zerave të preventivuar për ndriçimin publik.

Ata do të kryejnë:

- Vendosi e kabllave;
- Montimin e shtyllave;
- Instalimin e krahëve metalikë;
- Lidhjen e trupave ndriçues;
- Tokëzimin;
- Testimet përfundimtare.

Volumi prej rreth 1000 m linjë elektrike dhe 13 shtylla ndriçimi e justifikon plotësisht këtë numër punonjësish elektracist.

## **8. Punonjës Asfaltoshtrues – 3 persona**

Punimet e asfaltimit përfshijnë:

- Emulsionin bituminoz;
- Binderin;
- Tapetin asfaltik.

Tre asfaltoshtrues janë të nevojshëm për:

- Sistemimin manual të skajeve;
- Kontrollin e trashësisë;
- Rakordimet me bordurat;
- Përfundimin e nyjeve.

Për sipërfaqen mbi 2500 m<sup>2</sup> ky numër është i justifikuar.

## **9. Eskavatorist – 1 person**

Një operator ekskavatori është i nevojshëm për:

- Gërmimet;
- Formimin e kunetave;
- Gërmimet e pusëve;
- Vendosjen e tubacioneve.

Preventivi i këtij objekti i ka të parashikuara zerrat plus volumet e sipercituara dhe si rrjedhojë një ekskavatorist është i mjaftueshëm.

## **10. Automakinist – 1 person**

Automakinisti do të drejtojë/operojë:

- Grejderin;
- Rrulat;
- Dumperin;
- Pajisje të tjera teknologjike sipas fazës së punimeve.

Duke qenë se këto makineri nuk punojnë njëkohësisht gjatë gjithë kohës, një automakinist është i mjaftueshëm.

## **11. Buldozerist – 1 person**

Buldozeristi do të angazhohet në operimin e buldozorit për pastrimin dhe përgatitjen e terrenit, shtyrjen dhe sistemin e materialeve, nivelimin e platformes të punës, formimin e bankinave si dhe në realizimin e punimeve të tjera sipas kërkesave të projektit. Gjithashtu ai do të sigurojë përdorimin e rregullt të makinerisë duke kontribuar në ecurinë normale të punimeve në objekt.

Duke parë që punimet nuk janë të sasive dhe volumeve të mëdha, është menduar që një buldozerist është mjaftueshëm për këtë kanton.

## **12. Shoferë – 2 persona**

Objekti parashikon:

- Kamionë vetëshkarkues;
- Kamion transporti;
- Kamion me vinç;
- Kamionçinë.

Dy shoferë janë minimumi i nevojshëm për garantimin e transportit të materialeve dhe furnizimeve gjatë zbatimit.

Ky numër konsiderohet i justifikuar.

### **13. Hidraulikë – 2 persona**

Dy hidraulikë justifikohen nga:

- Vendosja e tubave HDPE Ø315 mm;
- Lidhjet e sistemit të kullimit;
- Montimi i pusetave;
- Rakordimet hidraulike.

Punimet e kullimit janë të shpërndara përgjatë gjithë gjatësisë së objektit dhe kërkojnë personel të specializuar.

Për këtë arsye 2 hidraulikë konsiderohen numër optimal dhe i justifikuar.

**2.3.6 Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën në datën e fundit të hapjes së ofertave, ku të ketë të punësuar minimumi 32 tridhjetë e dy persona.**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore në datën e fundit të hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në datën e fundit të hapjes së ofertave..

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësisë dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 42 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

**2.3.7** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

**Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :**

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 Ton	Ne pronësi ose me qera	Cope	2
2	Kamion me kapacitet mbajtës 10-13 Ton	Ne pronësi ose me qera	Cope	1
3	Kamion me vinç	Ne pronësi ose me qera	Cope	1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	Ne pronësi ose me qera	Cope	1
5	Eskavator me zinxhire	Ne pronësi ose me qera	Cope	1
6	Eskavator me goma (Mjet Teknologjik)	Ne pronësi ose me qera	Cope	1

7	Dumper me kapacitet deri ne 6 ton (Mjet Teknologjik)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
8	Autobetoniere Vetengarkuese 2.5-3.5 m3 (Mjet Teknologjik)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
9	Autopompe Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
10	Greider (Mjet Teknologjik)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
11	Asfaltoshtruese	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
12	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
13	Autobot uji	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
14	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
15	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
17	Rrul Hekur Gome mbi 10 ton	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
18	Rrul Hekur Hekur mbi 3 ton	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
19	Tranxhe per prerje hekuri	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
20	Betoforma	Ne pronesi ose me qera	m <sup>2</sup>	100
21	GPS	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
22	Total Station	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
23	Kokore	Ne pronesi ose me qera	Cope	32
24	Jelek	Ne pronesi ose me qera	Cope	32
25	Fikese Zjarri te levizshme	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
26	Tabela per sigurine ne objekt	Ne pronesi ose me qera	Cope	5
27	Komplet i ndihmes se shpejte	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
28	Buldozier	Ne pronesi ose me qera	Cope	1

***Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronesie original ose fotokopje e noteruar.***

- a) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e noteruar).
- b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të mbulojë afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, foto). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.
- d) Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve në terren. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar "për prokurimin publik".

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet "Deklaratë" nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit

kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. **1. Kamion vetëshkarkues ≥20 ton – 2 copë**

Dy kamionë vetëshkarkues janë të justifikuar nga:

- Transporti i materialeve të gërmimit;
- Furnizimi me çakëll;
- Furnizimi me stabilizant;
- Furnizimi me agregate për shtresat rrugore;
- Transporti i materialeve asfaltike.

Volumet e shtresave rrugore dhe mbushjeve tejkalojnë 1,400 m<sup>3</sup> materiale, ndërsa afati i punimeve është 90 ditë. Dy kamionë sigurojnë vazhdimësi furnizimi pa krijuar vonesa në frontet e punës.

## **2. Kamion 10–13 ton – 1 copë**

Ky mjet shërben për:

- Transport materialesh ndihmëse;
- Furnizim të pusetave;
- Transport tubacionesh;
- Furnizim të elementeve të sinjalistikës dhe ndriçimit.

Një kamion është i mjaftueshem dhe i justifikuar.

## **3. Kamion me vinç – 1 copë**

Nevojitet për:

- Shkarkimin e tubave HDPE;
- Vendosjen e pusetave;
- Montimin e shtyllave të ndriçimit;
- Vendosjen e guardrail-it.

Për shkak të peshës dhe përmasave të këtyre elementeve, një kamion me vinç është plotësisht i justifikuar.

## **4. Kamionçinë 3.5–5 ton – 1 copë**

Përdoret për:

- Transport të veglave;
- Transport të personelit teknik;
- Furnizime të vogla në kantier;
- Transport të materialeve ndihmëse.

Një kamioncine 3.5 – 5 ton është i mjaftueshme.

## **5. Ekskavator me zinxhir – 1 copë**

Përbën makinerinë kryesore të gërmimeve.

Përdoret për:

- Gërmimet e trupit të rrugës;
- Gërmimet e kunetave;
- Gërmimet e pusetave;
- Gërmimet për tubacione.

Volumet e gërmimeve të parashikuara në preventiv e justifikojnë plotësisht këtë mjet.

## **6. Ekskavator me goma – 1 copë**

Përdoret për:

- Punime të shpejta përgjatë aksit;
- Pastrim dhe sistemime lokale;
- Ndihmë në montimin e tubacioneve;
- Punime në zone urbane të banuar ku kërkohet lëvizshmëri më e madhe.

Një ekskavator me goma është i justifikuar.

## **7. Dumper deri 6 ton – 1 copë**

Përdoret për:

- Transport të materialeve në zona me akses të kufizuar;
- Transport lokal brenda kantierit;
- Shpërndarje materialeve për bankina dhe kuneta.

Një dumper deri në 6 ton konsiderohet i mjaftueshme duke analizuar preventivin.

## **8. Autobetoniere vetëngarkuese 2.5–3.5 m<sup>3</sup> – 1 copë**

Përdoret për:

- Betonime të shpërndara përgjatë aksit;
- Puseta;
- Bordura;
- Elemente ndihmëse.

Duke qenë se betonimet nuk janë të përqendruara në një pikë të vetme, kjo makineri është e argumentueshme.

## **9. Autopompë betoni – 1 copë**

Nevojitet për:

- Betonimin e murit pritës;
- Betonimin e elementeve ku aksesimi direkt është i kufizuar.

Megjithëse volumi i betonit nuk është shumë i madh, prania e saj mund të argumentohet për garantimin e cilësisë dhe shpejtësisë së hedhjes së betonit.

## **10. Grejder – 1 copë**

Argumentimi Teknik

Kjo makineri (Grejder), do të përdoret për nivelimin, profilimin dhe sistemimin e shtresave të rruges sipas kuotave dhe pjerresive të projektit. Përdorimi i tij siguron formimin e sakte të trupit të rruges, shpërndarjen uniforme të materialeve dhe përgatitjen e sipërfaqes për kompaktim dhe asfaltim, duke garantuar cilësi të larta dhe përputhshmëri me specifikimet teknike të projektit.

Makineria kryesore për:

- Profilimin e trupit të rrugës;
- Shtrirjen e çakullit;
- Shtrirjen e stabilizantit;
- Formimin e bankinave;
- Siguron saktësi gjeometrike të trupit të rruges;
- Garanton përputhshmëri me kuotat dhe pjerresive të projektit;
- Ndikon drejtpërdrejt në cilësinë përfundimtare të rruges.

Pa grejder nuk mund të realizohen parametrat gjeometrikë të rrugës.

## **11. Asfaltshtruese – 1 copë**

Plotësisht e domosdoshme për:

- Binderin;
- Tapetin asfaltik.

Sipërfaqja mbi 2,500 m<sup>2</sup> e justifikon plotësisht kete makineri.

## **2. Autobitumatrice – 1 copë**

Do te përdoret për:

- Shpërndarjen e emulsionit bituminoz.

Zëri i preventivit për emulsionin e bën këtë makineri të domosdoshme.

## **13. Autobot uji – 1 copë**

Do te përdoret për:

- Lagjen e shtresave;
- Arritjen e lagështisë optimale për ngjeshje;
- Kontrollin e pluhurave.

Një autobot uji është teper i nevojshem ne kete kantier.

## **14. Autobetoniere – 2 copë**

Dy autobetoniere janë të pranueshme dhe te argumentuara me arsyetimin e sigurimit te vazhdimesise se punes ne katier

Megjithatë, duke parë volumet relativisht modeste të betonit,eshte menduar per 2 autobetoniere per sigurimin e vazhdimesise se punes ne kantier pa nderpreje duke mare ne konsiderate vonesat qe mund te ndodhin per shkak defektesh etj...

Prania e dy autobetoniereve argumentohet si rezervë operationale dhe për shmangien e ndërprerjeve.

## **15. Vibrator betoni – 1 copë**

I domosdoshëm për:

- Muret;
- Pusetat;
- Bordurat;
- Trotuaret.

Garanton kompaktësinë e betonit, ai do te perdoret gjate procesit te betonimit per ngjeshjen e betonit te fresket,eliminimin e ajrit te bllokuar dhe sigurimin e mbushjes se plote te kallepeve.

Perdorimi i tij siguron/garanton arritjen e densitetit dhe rezistences se projektuar te betonit,permision aderencen me armaturen (aderenca eshte forca e ngjitjes dhe e bashkeveprimit qe zhvillohet ndermjet dy materialeve, duke siguruar transmetimin e forcave nga njeri material tek tjetri) dhe siguron cilesine e kerkuar te elementeve konstruktive sipas standarteve teknike te zbatimit.

## **16. Rrul hekur-gomë >10 ton – 1 copë**

Makineri kryesore për:

- Ngjeshjen e shtresës së çakullit;
- Ngjeshjen e stabilizantit;
- Ngjeshjen e bankinave.

Plotësisht i justifikuar, pasi kjo makineri do te perdoret per ngjeshjen e shtresave asfaltike dhe shtresave rrugore , me qellim arritjen e densitetit dhe kompaktesise se kerkuar sipas specifikimeve teknike.Kombinimi i cilindrit metalik me rrotat e gomes siguron ngjeshjen uniforme, eliminimin e boshlleqeve dhe permisimin e cilesise se sipërfaqes se perfunduar.

## **17. Rrul hekur-hekur >3 ton – 1 copë**

Përdoret për:

- Ngjeshjen përfundimtare të asfaltit;
- Mbylljen e sipërfaqes asfaltike.

Edhe ky mjet eshte i justifikuar,pasi kjo makineri do te perdoret per ngjeshjen e shtresave asfaltike dhe shtresave rrugore , me qellim arritjen e densitetit, kompaktesise dhe rrafshesise se kerkur nga specifikimet teknike te projektit. Perdorimi i tij garanton eliminimin e boshlleqeve, permisimin e cilesise se sipërfaqes se asfaltit dhe sigurimin e qendrueshmerise afatgjate te konstruksionit rrugor.

## **18. Tranxhë për prerje hekuri – 1 copë**

Nevojitet për:

- Prerjen e armaturave;
- Përgatitjen e skeleteve të betonarmës.
- Redukton humbjet e materialit
- Permision cilesine e montimit te armatures
- Ul kohen dhe koston e punes

- Rrit shpejtesine e punes krahasuar me prerjen manual.

Tranxhe per prerje hekuri sherben per prerjen e shufrave te celikut dhe armatures sipas dimensioneve te percaktuara ne project. Perdorimi i saj garanton saktesi ne pergatitjen e elementeve te armatures, rrit produktivitetin e punes, minimizon humbjet e materialit dhe siguron cilesine e nevojshme per realizimin e punimeve te betoformave. Duke pare volumet dhe sasite ne preventive 1 (nje) tranxhe per prerje hekuri eshte mese e nevojshme dhe e argumentuar.

## **19. Betoforma – 100 m<sup>2</sup>**

Justifikohet nga:

- Muri pritës;
- Pusetat;
- Bordurat;
- Punimet e trotuareve.
- Formesim korekt te elementeve te betonit sipas projektit
- Rezistence ndaj presionit te betonit te fresket
- Riperdorim ne disa cikle pune, duke rritur efikasitetin ekonomik
- Shpejtesi dhe dhe siguri ne realizimin e punimeve te kallepimit

Sasia prej 100 m<sup>2</sup> lejon qarkullimin e kallëpeve gjatë gjithë kantierit. Keto betoforma ne sasine 100 m<sup>2</sup> do te perdoren per realizimin e kallepeve te elementeve te betonarmeve, duke garantuar formesim te sakte, stabilitet gjate betonimit dhe cilesi te larte te siperfaqes se betonit. Kjo sasi eshte mese e argumentuar per sasine e punes qe do te kryhet ne kantier e mbeshetur ne volumet e preventivit.

## **20. GPS – 1 copë**

Kjo pajisje nevojitet për:

- Piketim i akseve, kufijve dhe elementeve te projektit:
- Kontroll/ percaktim te koordinatave X,Y, dhe Z te pikave ne terren:
- Kontroll/verifikim pozicionesh.dhe kuotave gjate zbatimit te punimeve:
- Matja dhe refjistrimi i te dhenave topografike:
- Kontroll i volumeve dhe siperfaqeve te punimeve

GPS eshte pajisje bazë për zbatimin e objektit/projektit. GPS-I do te perdoret per kryerjen e matjeve topografike, piketimin e elementeve te projektit dhe kontrollin gjeometrik te punimeve ne terren. Perdorimi i tij siguron saktesi ne vendosjen e akseve, kufijve dhe niveleve te projektit duke garantuar qe punimet te realizohen ne perputhje me koordinatat dhe specifikimet teknike te

miratuara. Edhe kjo pasisje eshte mese e nevojshme ne kantier dhe e argumentuar per punen qe do te kryeje.

## **21. Total Station – 1 copë**

Kjo pajisje nevojitet për:

- Kontroll i kuotave dhe pozicionit te punimeve gjate zbatimit;
- Kontroll profilesh;
- Realizimi i rilevimeve/matjeve topografike dhe pergatitja e te dhenave per hartografi dhe projektim:
- Matja e distancave me precision te larte.
- Matja e kendeve

Total Station eshte nje pajisje topografike e domosdoshme per zbatimin dhe kontrollin e punimeve te ndertimit. Ajo do te perdoret ne kantier per piketimin e sakte te akseve te projektit, percaktimin e koordinatave dhe kuotave si dhe per verifikimin e pozicionit gjeometrik te elementeve gjate ndertimit dhe zbatimit te projektit. Perdorimi i kesaj pajisje do te garantoje ne kete kantier saktesi te larte ne matje,minimizon gabimet e vendosjes ne terren dhe siguron perputhshmerine e punimeve me projektin Teknik. Plotësisht i justifikuar.

## **22. Kaskë mbrojtëse (Kokore)**

Pajisje te detyrueshme te sigurisë për të gjithë personelin që operon në kantier.Kokorja/et (kaske/at mbrojtese) eshte pajisje personale e mbrojtjes ne pune (PPE), e projektuar per te mbrojtur koken e punonjesve nga goditjet, renia e objekteve,

perplasjet me elemente te forte te kantierit dhe rreziqe te tjera qe mund te shkaktojne demtime te renda ose fatale

Ndikimi ne zbatimin e punimeve;

- Mbron jeten dhe shendetin punonjesve: nga demtimet ne koke;
- Ul rrezikun e aksidenteve te renda dhe nderprerjeve te punes;
- Siguron vazhdimesine e procesit te ndertimit pa vonesa te shkaktuara bga incidentet ne kantier:
- Permbush kerkesat ligjore dhe standartet e sigurise dhe shendetit ne pune;
- Redukton kostot qe mund te vijne nga aksidentet, trajtimet mjeksore dhe pezullimi I punimeve.

Keto pajisje mbrojtese duhen te jene te disponueshme ne kantierin e ndertimit pasi perdorimi i tyre ndikon drejtperdrejt ne parandalimin e aksidenteve, ruajtjen e shendetit te punonjesve dhe mbarevajtjen e procesit te ndertimit ne perputhje me me kerkesat e sigurise dhe shendetit ne pune.

## **23. Jelek reflektues**

### Argumentim Teknik

Jeleket reflektues jane pajisje individuale e mbrojtjes (PPE) te projektuar per te rritur dukshmerine e punonjesve ne ambientet e punes, vecanerisht ne kantiere ndertimi si kjo infrastrukture rrugore, me ndricim te kufizuar.

Fale ngjyrave me kontrast te larte dhe shirateve reflektues, jeleku mundeson identifikimin e menjehershem te punonjesve nga drejtuesit/operatoret e mjeteve motorike dhe personat e tjere qe veprojne ne kantier, duke reduktuar ndjeshem rrezikun e perplasjeve dhe aksidenteve.

Ndikimi ne zbatimin e punimeve :

- Punime pranë qarkullimit rrugor;
- Rritjen e dukshmërisë së punonjësve ne cdo moment te punes:
- Ul rrezikun e aksidenteve nga makinerite e renda dhe automjetet e kantierit e me gjere:
- Permision organizimin dhe kontrollin operacional te kantierit;
- Koontribuon ne mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve.

Perdorimi i ketyre jelekeve eshte shume i nevojshem ne kantier per te gjithë stafin dhe numrin e punonjesve , pasi perdorimi i tyre minimizon rrezikun e aksidenteve nga levizja e makinerive dhe mjeteve, mundeson identifikimin e menjehershem te personelit dhe garanton zhvillimin e sigurt te proceseve te punes ne perputhje me kerkesat e sigurise dhe shendetit ne pune.

Pajisje te detyrueshme e sigurisë...

## **24. Fikëse zjarri të lëvizshme – 2 copë**

### Argumentim Teknik

Fikeset e zjarrit te levizshme, jane pajisje te sigurise kunder zjarrit qe perdoren per nderhyrje te menjehershme ne fazat e para ten je vatre zjarri, me qellim parandalimin e perhapjes se saj dhe minimizimin e demeve ndaj personelit, makinerive, pajisjeve dhe materialeve te pranishme ne kantier.

Duhet theksuar se kantieri ne fjale eshte objekt per rehabilitimin apo rikonstruksionin e rrugeve te brendshme te fshatit Qerret, Njesia Administrative Pishaj, I cili do te zhvillohet ne ambient te hapur, ku gjta punimeve do te perdoren mjete dhe makineri me karburant, pajisje mekanike dhe materiale te ndryshme, te cilat paraqesin rrezik potencial per shperthim ose zjarr si pasoje e defekteve teknike, rrjedhjeve te karburantit, mbinxehjes se motoreve apo shkendijave aksidentale.

Per kete arsye, eshte parashikuar vendosja e 2 (dy) fikeseve te levizshme te zjarrit, te shperndara ne menyre te tille qe te sigurohet akses i shpejte dhe nderhyrje efektive ne rast emergjence.

Rendesia ne kantier :

- Prania e makinerive me karburant;
- Punimet asfaltike;
- Pajisjet elektrike;
- Mundesojne reagim te shpejte dhe te menjehershem ne rast zjarri;
- Kufizojne perhapjen e flakeve deri ne mberritjen e sherbimeve zjarrfikese;
- Mbrojne jeten dhe sigurine e punonjesve;
- Reduktojne rrezikun e nderprjes se punimeve dhe demeve ekonomike;
- Permbushin kerkesat e sigurise dhe mbrojtjes nga zjarri ne kantier.

Vendosja e fikesëve të zjarrit të levizshme 2 (dy) cope, në kantier siguron mbrojtjen e personelit, makinerive dhe pajisjeve nga rreziku i zjarrit, garanton reagim të shpejtë në situatë emergjente dhe kontribuon në zhvillimin e sigurt të punimeve në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri.

## **25. Tabela sigurie – 5 copë**

Argumentim Teknik

Tabelat e sigurisë të përlogaritura të mjaftueshme në këto kantier 5 (pese) cope nuk janë thjesht element informues. Ato janë masa të detyrueshme për menaxhimin e rrezikut, orientimin e përdoruesve të rrugës dhe mbrojtjen e punonjesve gjatë zhvillimit/kryerjes të punimeve. Tabelat e sigurisë do të përdoren për sinjalizimin, paralajmërimin dhe informimin e punonjesve, banorëve dhe përdoruesve të rrugës mbi praninë e punimeve dhe rreziqeve që lidhen me to. Ato duhet dhe do të vendosen në pozicione strategjike përgjatë kantierit për të gatuar qarkullim të sigurt dhe për të parandaluar aksidentet.

Në një kantier të tilla, rikonstruksion rrugësh të brendshme në zone rurale (fshati), ku levizin njëkohësisht banorë, automjete, kembesore, mjete bujqësore dhe makineri ndertimi, sinjalizimi i qarte i zonës së punimeve është thelbësor për shmangien e incidenteve dhe ruajtjen e sigurisë publike.

Rendesia ne zbatim :

- Paralajmëron për praninë e kantierit dhe punimeve në zhvillim;
- Informojnë përdoruesit e rrugës për kufizimet dhe devijimet e mundshme;
- Sinjalizojnë zonat me rrezik të shtuar;
- Udhëzojnë qarkullimin e automjeteve dhe kembesoreve;
- Rrisin sigurinë e punonjesve që operojnë në kantier.

Mungesa e tyre mund të sjellë :

- Hyrje të pa autorizuara në zonën e punës (kantier):

- Aksidente me automjete ose kembesore;
- Demtime te pajisjeve dhe makinerive:
- Nderprerje te punimeve:
- Pergjegjesi ligjore per subjektin zbatues.

Per kete kantier **5 (pesë)** tabela sigurie konsiderohen numër i arsyeshëm dhe i mire argumentuar.

## **26. Komplet i ndihmës së shpejtë – 2 copë**

Argumentim Teknik :

Kompletet e ndihmes se shpejte jane pajisje te domosdoshme te sigurise ne kantier, te cilat sherbejne per trajtimin e menjehershem te demtimeve te lehta dhe stabilizimin fillestar te gjendjes shendetsore te punonjesve deri ne nderhyrjen e sherbimeve mjeksore profesionale.

Ne kete kantier, permisim te rrugeve te brendshem ne zona ruarale, ku ka aktivitet qe perfshin perdorim makinerish, veglash prerese, materiale ndertimi, levizje automjetesh dhe punime ne terren relativisht te pabarabarte, rreziku i aksidenteve te vogla ose te mesme eshte i pranishem dhe i vazhdueshem. Per kete arsye, disponimi i ndihmes se shpejte ne vend eshte mase e detyrueshme dhe kritike.

Rendesia ne kantier.

Ne aspktin e sigurise, kompletet e ndihmes se shpejte jane po aq thelbesore sa pajisje mbrojtese personale, pasi :

- Ato mundesojne nderhyrjen ne momentin kritik pas aksidentit ku minuta te vlefshme mund te percaktojne shkallen e demit:
- Zvogelojne kohen e reagimit dhe varesine nga ndihma e jashtme:
- Rrisin nivelin e organizimit dhe pergjegjesise ne kantier:
- Jane pjese te detyrueshme te sistemit te menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune.

Perdorimi I tyre kontribuon drejtperdrejt ne mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve dhe ne garantimin e vazhdimesise se sigurt te punimeve.

Një komplet duhet të jetë pranë zyrës së kantierit dhe një pranë frontit aktiv të punimeve.

Dy komplete janë të justifikuara plotësisht për shkak të natyrës së punimeve me makineri të rënda.

## 27. Buldozer 1 (nje) cope

Argumentim teknik

Buldozeri do te perdoret per pastrimin dhe pergatitjen e terrenit,shtryjen dhe sistemimin e materialeve te germimit, nivelimit paraparak te platformes se punes,formimin e bankinave si dhe punime te tjera tokepunimi te nevojshme per realizimin e objektit sipas kerkesave teknike te projektit te mbeshetura nga preventivi.

Punet qe do te kryeje :

- Hapja dhe pastrimi i terrenit nga bimesia, guret, mbetjet dhe pengesat e ndryshme.
- Nivelimi paraparak i siperfaqeve para fillimit te punimeve te ndertimit.
- Hapja e rrugeve te perkohshme te aksit ne kantier.
- Perhapja dhe shperndarja e materialeve te depozituara ne kantier.
- Shtyrja dhe zhvendosja e dheut, reres, zhavorit dhe materialeve te tjera ne distanca te shkurtra....etj.....

Duke pare qe punimet nuk jane te sasive dhe volumeve te medha, eshte menduar qe nje buldozer eshte mese i mjaftueshem per kete kantier.

**2.3.8** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- **Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.14 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

**2.3.9** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte), se bashke me Akt Miratimin me kodet 17 01 01; 17 01 07; 17 03 02; 17 04 01; 17 04 02; 17 04 05; 17 04 07; 17 04 11; 17 05 04; 17 05 06; 17 05 08; 17 09 04; 20 02 02 në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

**Argumentim:** Kërkesa për pajisjen e operatorëve ekonomikë me licencë të vlefshme të lëshuar nga QKL për kategorinë **Kodi III.2.B (grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte)**, si dhe disponimi i Akt-Miratimit për kodet përkatëse të mbetjeve, vendoset në përputhje me **ligjin nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**, i ndryshuar, dhe **VKM nr. 538, datë 26.05.2009**, i ndryshuar.

Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që operatorët ekonomikë janë të autorizuar ligjërisht për të kryer aktivitetin objekt prokurimi dhe që disponojnë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe mjedisor për trajtimin e mbetjeve sipas kodeve përkatëse.

Vendosja e këtij kriteri është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke synuar realizimin e saj në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbrojtjen e mjedisit.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe*

*nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**ORGENT CONIKU**

**SAMUEL VELIU**

**LOINA ZOGU**

**ZYRTARI I AUTORIZUAR**

**ZV/KRYETARI**

**XHILSON BAJRAMI**